



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:005412
Datë: 28.08.2018
Numri i dokumentit: 00108034

P.nr. 193/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Labinot Jetishi, në lëndën penale kundër të akuzuarit J. A. nga Prizreni, për shkak të veprave penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve ose materialeve plasëse nga neni 372 par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.236-7/2018, të datës 08.02.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar duke vendosur mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Elfete Purova, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. B. K. nga Prizreni, me datë 26.07.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

J. A., nga i ati B., e ëma Z. e vajzërisë H., i lindur më *data e lindjes...* në Prizren, me banim në rr. ... nr..., në Prizren, i pa punë, beqar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në arrest shtëpiak nga data 23.01.2018 deri më datë 23.02.2018.

ËSHTË FAJTOR

- I. Se me 23.01.2018, rreth orës 12:30 min, në Prizren tek pompa e benzinës “S. P.”, në

lagjen ..., shkel ligjin e zbatueshëm në lidhje me armët apo materialet plasëse, importon, eksporton, blenë, furnizon, transporton, prodhon, këmben, ndërmjetëson ose shet armën materialet plasëse, importon armën, vënia në dorë e të cilës qytetarëve fare nuk u lejohet, në atë mënyrë i pandehuri në faqen "Merrjep" ka postuar një ofertë me dy pistoleta, gjatë një plani operativ-taktik nga stacioni policor në Prizren, blerjes së simuluar të sendeve personat zyrtar përmes telefonit kontaktojnë me të pandehurin në numrin e telefonit *numri i telefonit...*, kanë biseduar në lidhje me armën, i njëjti u ka thënë se e ka në shitje dhe atë për shumën e të hollave 150 eurove, ku i pandehuri ka pranuar se në shtëpi e ka armën, ku së bashku shkojnë në shtëpinë e të pandehurit, me çrrastë janë gjetur një pistoletë "Valter" prodhim Gjerman CP99 4.5mm me nr. serik Ji61573876, një bocë e vogël ngjyrë hiri me mbishkrimin UMAREX, një kuti plastike për pastrimin e armëve, një kuti metali e rrumbullakët ngjyrë hiri e zbrazur e municionit 4.5 mm, një pistoletë "Ekol Special 99, kalibri 9mm me nr. serik EV-17070262 dhe një karikator i zbrazur të cilat janë sekuestruar nga ana e pjesëtarëve të policisë.

Kështu që ka kryer veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve ose materialeve plasëse nga neni 372 par.1 të KPK-së.

- II. Se me datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitiv nën I, është gjetë se pa autorizim të organit kompetentë ka mbajtur në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar një pistoletë "Valter" prodhim Gjerman CP99 4.5mm me nr. serik Ji61573876, dhe një pistoletë një pistoletë "Ekol Special 99", kalibri 9mm me nr. serik EV-17070262.

Kështu që ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Andaj në kuptim të nenit 7, 41, 42, 49,5., 51, 52, 73, 75, 76 dhe nenit 365 të KPK-së, e

GJYKON

- për veprën penale për pikën nën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro si dhe dënim me burgim prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nëse i pandehuri gjatë kësaj periudhe nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale;

-për veprën penale në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënimin me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro.

Gjykata konform nenit 80 të KPK-së, i shqipton:

DËNIM UNIK

Dënimin me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha në arrest shtëpiak prej datës 23.01.2018 deri më datën 23.02.2018, përkatësisht shumën e mbetur të gjobës prej **400 (katërqind) euro**, të cilin dënim me gjobë i akuzuari është i obliguar të paguaj në 2 (dy) këste mujore dhe atë kësti i parë për pagesë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, ndërsa kësti i dytë në afat prej 1 (një) muaji nga pagesa e kështit paraprak.

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron të paguaj dënimet me gjobë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burg ashtu që çdo 20 (njëzet) euro të dënimit me gjobë do të llogaritet (1) një ditë burgu.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2, nën paragrafi 2.6 të KPK-së, të akuzuarit i shqiptohet edhe:

DËNIMI PLOTËSUES

Konfiskohen një pistoletë “Valter” prodhim Gjerman CP99 4.5mm me nr. serik Ji61573876, dhe një pistoletë një pistoletë “Ekol Special 99”, kalibri 9mm me nr. serik EV-17070262.

Obligohet i akuzuarit që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) Euro, si dhe shumën prej 30 (tridhjetë) Euro në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, krejt këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren në këtë Gjykatë, ka parashtruar aktakuzë PP/II.nr.236-7/2018, të datës 08.02.2018, ndaj të akuzuarit J. A., për shkak të veprave penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve ose materialeve plasëse nga neni 372 par.1 të KPK-së dhe mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Departamenti i Përgjithshëm, Gjykatës ka paraqitur marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.236-7/18, të datës 27.03.2018.

Gjykata duke vepruar në bazë të marrëveshjes së paraqitur më datën 26.07.2018 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ku ka prezantuar e prokurori i shtetit Elfete Purova, i akuzuari J. A. dhe mbrojtësi i tij av. B. K. nga Prizreni.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestarë, në pajtim me dispozitat e nenit 247 paragrafi 4 të KPPK-së ka shqyrtuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, ku ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij si dhe prokurorin e shtetit lidhur me pretendimet e tyre sa i përket marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit gjatë seancës ka deklaruar se ngel në tërësi pranë marrëveshjes dhe kushteve që i kanë paraqitur në marrëveshje me të akuzuarin J. A., duke theksuar se marrëveshja është lidhur në pajtim me dispozitat ligjore, duke propozuar gjykatës që kjo marrëveshje të aprovohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit J. A. - avokati B. K., ka deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshme me të akuzuarin J. A., i cili pasi që është njoftuar me favoret dhe pasojat e lidhjes së marrëveshjes, vullnetarisht pa presion ka pranuar që të hyhet në negociata të arritjes së marrëveshjes, e pranon marrëveshjen si të tij dhe të njëjtin e ka nënshkruar pa vërejtje. I njëjti është pënduar për veprën që e ka kryer, po ashtu ka premtuar Prokurorit të shtetit po edhe gjykatës se në të ardhmen asnjëherë nuk do të bie ndesh me Ligjin, andaj i propozojë që Gjykata në kuptim të nenit 233 par. 16 të KPPK-së ta aprovojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë duke i shqiptuar një dënim minimal të paraparë në marrëveshje.

I akuzuari J. A. në tërësi është pajtuar me deklaratën e dhënë nga mbrojtësi i tij, është pënduar dhe i premtton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të Prokurorit të Shtetit, akuzuarit dhe mbrojtësit të tij lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë konstatoi se i akuzuari J. A. e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av. B. K., i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari dhe se nuk parashihet asnjë nga rrethanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par. 1 dhe 2 i KPPK-së për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata ka konstatuar se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është lidhur në pajtim me nenin 233 par. 2 të KPPK-së dhe të njëjtën e kanë pranuar.

Gjykata ka vërtetuar këtë gjendja faktike:

Se me 23.01.2018, rreth orës 12:30 min, në Prizren tek pompa e benzinës “S P.”, në lagjen ..., shkel ligjin e zbatueshëm në lidhje me armët apo materialet plasëse, importon, eksporton, blenë, furnizon, transporton, prodhon këmben, ndërmjetëson ose shet armën materialet plasëse, importon armën, vënia në dorë e të cilës qytetarëve fare nuk u lejohet, në atë mënyrë i pandehuri në faqen “Merrjep” ka postuar një ofertë me dy pistoleta, gjatë një plani operativ-taktik nga stacioni policor në Prizren, blerjes së simuluar të sendeve personat zyrtar përmes telefonit kontaktojnë me të pandehurin në numrin e telefonit *numri i telefonit...*, kanë biseduar në lidhje me armën, i njëjti u ka thënë se e ka në shitje dhe atë për shumën e të

hollave 150 eurove, ku i pandehuri ka pranuar se në shtëpi e ka armën , ku së bashku shkojnë në shtëpinë e të pandehurit, me çrrastë janë gjetur një pistoletë “Valter” prodhim Gjerman CP99 4.5mm me nr serik Ji61573876, një bocë e vogël ngjyrë hiri me mbishkrimin UMAREX, një kuti plastike për pastrimin e armëve, një kuti metali e rrumbullakët ngjyrë hiri e zbrazur e municionit 4.5 mm, një pistoletë “Ekol Special 99, kalibri 9mm me nr serik EV-17070262 dhe një karikator i zbrazur të cilat janë sekuestruar nga ana e pjesëtarëve të policisë. Kështu që ka kryer veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e pa autorizuar e armëve ose materialeve plasëse nga neni 372 par.1 të KPK-së.

Po ashtu, me datë, kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitiv nën I, është gjetë se pa autorizim të organit kompetentë ka mbajtur në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar një pistoletë “Valter” prodhim Gjerman CP99 4.5mm me nr serik Ji61573876, dhe një pistoletë një pistoletë “Ekol Special 99”, kalibri 9mm me nr. serik EV-17070262. Kështu që ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Gjykata nga të lartcekurat ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin e rekomanduar të marrëveshjes për pranimit e fajësisë, gjykata dëgjoi deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimin e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimitin e fajësisë ashtu duke i marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave rënduese ka marrë mënyrën e kryerjes së veprave penale, rrezikshmërinë shoqërore, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarit morri se këta kanë pasur qëndrim korrekt, premtojnë se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, pranimitin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimitin e fajësisë, andaj gjykata duke pasur parasysh se i akuzuari ka pranuar fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimitin e fajësisë sa i përket vendimit mbi dënimin aplikoi dispozitat e nenit 73 të KPK-së të propozuar edhe në marrëveshjen mbi pranimitin e fajësisë, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 41, 45 dhe 46 të KPK-së dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 193/18, të datës 26.07.2018

B. Profesional
Labinot Jetishi

Gjyqtari
Gani Kastrati

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:005412
Datë: 28.08.2018
Numri i dokumentit: 00108034